Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
*Kuvendi – Skupština - Assembly*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa - Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot. 08/358/Do-238
Data 25.06.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

---

**Legjislatura VIII**
**Sesioni pranveror**

**PËR: Deputetët e Kuvendit**
**CC: Kryesinë e Kuvendit**

**NGA: Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal**

**LËNDA: Rekomandim për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës**

**Datë: 25 qershor 2021**

---

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, të nenit 28 paragrafi 2, të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 22 qershor 2021, diskutoi lidhur me shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

**R e k o m a n d i m**

**I. I Rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,**

1. Sali Bashota,
2. Agron Gashi,
3. Lirim Geci,
4. Ilir Bytyqi,
5. Albinot Maloku,
6. Bajram Mjeku,
7. Petrit Musolli, dhe
8. Fadil Miftari.

**II. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet deputetja, Doarsa Kica-Xhelili, kryetare e Komisionit.**

**Arsyetim**

Komisioni, në bazë të nenit 28 paragrafi 2, të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës (këtu e tutje "Ligji për RTK"), ka iniciuar procedurën për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (këtu e tutje "RTK").

Në vijim të këtij arsyetimi, paraqesim së pari kompetencat e Komisioneve përkatëse për të bërë propozimin për shkarkimin e anëtarëve të Bordit, duke pasuar me arsyetimin që adreson shkeljet e këtij Bordi karshi kompetencave që definohen në Nenin 29 të Ligjit për RTK.

## 1. Kompetenca për shkarkim të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Në përputhje me Nenin 28, Paragrafi 2 të Ligjit për RTK-në, shkarkimi i një anëtari të Bordit, mund të bëhet nga:

> *2. Shkarkimi i një anëtari nga Bordi do të bëhet sipas procedurës në vijim: 2.1. propozimi për shkarkim vie nga Bordi i RTK-së me kërkesën e shumicës së thjeshtë të numrit të anëtarëve të Bordit* ***ose të ndonjë iniciative tjetër nga jashtë sipas kushteve të përcaktuara nga paragrafi 3. i këtij neni****.*
> *2.2. Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të Bordit.*

Pra, në përputhje me paragrafin e sipërcituar, anëtari i Bordit mund të shkarkohet, ndër të tjera, nga një iniciativë tjetër nga jashtë, që nënkupton jashtë formatit të Bordit të RTK-së, ku më pas legjitimohet nga vota e shumicës së thjeshtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në rastin konkret, iniciativa është marrë nga dy komisione parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, i cili i ka rekomanduar Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal që ta shqyrtojë rekomandimin për shkarkimin e bordit të RTK, për shkak të gjetjeve që janë arsyetuar në këtë rekomandim, të reflektuara në pikën 2. më poshtë.

Më pas, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, duke qenë komision funksional parlamentar të cilit i raporton RTK, e ka mbështetur Rekomandimin e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, por duke shtuar edhe gjetjet e veta për lëshime të dispozitave përkatëse të Ligjit për RTK, të reflektuara në pikën 3. më poshtë.

Në kuptim të mundësisë së shkarkimit të anëtarëve një nga një, apo më shumë se një anëtari të Bordit, Ligji për RTK nuk bën referencë në emërtimin njëjës si kufizim të mundësisë për shkarkim të më shumë se një anëtari njëherësh. Si referencë, ka edhe nene tjera përbrenda Ligjit për RTK që bën referim njëjës por aplikohet në shumicë (shiko Nenin 27).

Si analogji, mund të marrim edhe praktikën e Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e shkarkimit të dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media në vitin 2013. Ligji Nr. 04/L-44 Për Komisionin e Pavarur të Mediave, kur flet për shkarkimin e anëtarit të tij flet ne njëjës (pra bën referencë në një anëtar), por megjithatë në seancën e datës 19, 20 dhe 26 dhjetor të vitit 2013, u shkarkuan njëheri dy anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Rekomandimi për shkarkim bëhet në përputhje me Nenin 28, Paragrafi 3 i Ligjit për RTK i cili flet për kriteret e shkarkimit të anëtarëve të Bordit, ku ndër tjera liston edhe bazën aktuale të rekomandimit, përkatësisht:

3.1. paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon ti përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit;

Kur flasim për detyrat e anëtarit të Bordit, ato përfshihen në përgjithësi me zbatimin e Ligjit për RTK, e ne vecanti Neni 29 i Ligjit për RTK.

## 2. Arsyetimi i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere

### 2.1. Dështimi për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me punën e RTK-së

Anëtarët e Bordit Drejtues në vazhdimësi kanë dështuar të sigurojnë qasje të papenguar dhe pakontestuar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në inicim dhe kompletim të auditimit të rregullsisë dhe performances. Në bazë të Nenit 136, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, përfshirë veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike. Ligji 04/L-046 e përcakton RTK-në si institucion publik.

Ligji Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike, Neni 19, paragrafi 1, ka përcaktuar se Auditori i Përgjithshëm për çdo vit fiskal bën auditimin e ekzekutimit të buxhetit në të gjitha organizatat buxhetore, autoritetet publike, ndërmarrjet publike si dhe të gjitha fondet dhe programet publike, pavarësisht mënyrës së menaxhimit apo financimit të tyre. Sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore, Neni 3, paragrafi 1.25 për vitin 2021, RTK është organizatë buxhetore me kod organizativ 248 dhe e cila ka përfituar financim vjetor në vlerë njëmbëdhjetë million e dyqind mijë eruo (11,200,000 Euro) në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Mjetet sipas Ligjit 07/L-041 ndahen sipas vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Opinoni Ligjor i Drejtorisë së përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 04.06.2021, specifikon se asnjëherë nuk kishte ndonjë provision në kuadër të Ligjit të RTK-së që konteston autoritetin e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Në bazë të shkresave të pranuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Raportimit të Auditorit të Përgjithshëm pranë Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere të vitit 2021, janë evidentuar pengesa të pareshtura dhe kontestim i procesit të auditimit nga Menaxhmenti i RTK-së. Duke amnestuar këtë situatë të pengimit të personit zyrtar, Bordi i RTK-së ka dështuar të luaj rolin vendimmarrës dhe mbikëqyrës siç përcaktohet në Nenin 37 të Ligjit të RTK-së. Duhet nënvizuar se në këtë situatë Bordi i RTK-së i është nënshtruar udhëzimeve të Drejtorit të Përgjithshëm dhe kjo bjen ndesh me piken 25.7 të Ligjit mbi RTK-në. Më këtë veprim anëtarët e Bordit të RTK-së kanë vepruar në kundërshtim me paragrafin 2.10 të Nenit 29 të Ligjit mbi televizionin publik dhe Nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

### 2.2. Dështimi për të përpiluar një strategji afatgjate për zhvillimin dhe financimin e RTK-së

Sipas Ligjit të RTK-së, Neni 21, mbi Burimet e Financimit, televizioni publik ishte paraparë të përfitonte financim direkt nga buxheti shtetëror për një periudhë tranzitore trevjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi. Themeluesi me propozimin e Bordit të RTK-së duhej të kishte vendosur për nivelin e taksës për transmetuesin publik por kjo nuk ka ndodhur. Bordi aktual nuk ka propozuar ndonjë strategji për të siguruar financim adekuat, të qëndrueshëm dhe transparent ndaj publikut. Nuk është evidente nga procesverbalet dhe diskutimet e mbledhjeve të realizuara gjatë vitit 2020 që kjo çështje të jetë diskutuar apo trajtuar.

Gjatë raportimit pranë Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, Bordi ka dështuar të performojë rolin e tij fiduciar dhe informuar publikun në mënyrë të drejtë mbi provizionet e nenit 23 mbi Financimin nga Themeluesi, sipas të cilit Kuvendi në varësi të mundësive

buxhetore, siguron mjete financiare. Komisioni ka qenë në presion të vazhdueshëm për të ushtruar funksionin e tij mbikëqyrës siç parashihet në Ligjin për Ndarje Buxhetore, Ligjin e RTK-së dhe Statutin e RTK-së, të miratuar nga Bordi. Raportimi tremujor dhe periodik i Bordit është definuar në Ligjin për RTK-në, paragrafi 8 dhe 9 të Nenit 30. Përgjegjësia e Bordit për të siguruar raportim financiar mbi bazën e Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike. Raportet financiare tremujore dhe vjetore nuk kanë ndonjë ndërlidhje ndërmjet aktiviteteve dhe shpenzimeve dhe nuk mbështeten në parimin akrual. Nuk janë të kategorizuara dhe në disa raste përfshijnë shpenzimve të paplanifikuara dhe të ripërseritura.

Bazuar në raportet financiare të ekzekutuara, shpenzimet e RTK-së për paga për vitin 2008 ishin € 3,698,982 e totalit të shpenzimeve. Numri i punonjësve për vitin 2008 ishte 424 plus 99 bashkëpunëtorë të pavarur. Në vitin 2020, shpenzimet për paga dhe mëditje janë rritur në € 8,625,000 nga totali i shpenzimeve prej € 12,591,000 apo 68.5%. Në vitin 2020 janë raportuar 1,024 të punësuar, nga të cilët 806 me kontrata të rregullta dhe 218 të tjerë me orare të pjesshme si gazetarë, aktorë apo korrespondentë jashtë vendit. Kjo tendencë e shpenzimeve dhe rritje e pakontrolluar e numrit të punëtorëve ka shkaktuar gjendje të rëndë financiare tek televizioni publik, e shprehur përmes borxhit që varion ndërmjet 2.6 – 5.2 milion euro, ndërmjet 2018-2020. Bordi do të duhej të siguronte që televizioni publik të mos jetë vetëm në shërbim të vetvetes, por ndaj publikut dhe jo vetëm sa për të operuar, por edhe për të mbetur në garë me kanalet tjera komerciale, si në aspektin teknologjik, ashtu edhe në cilësinë e programeve. Duke toleruar një zhvillim të tillë, Bordi ka dështuar të përmbushë detyrën e tij për të kontrolluar shpenzimet e televizionit public, ashtu siç parashihet në kuadër të kompetencave të tyre. Sipas nenit 26, paragrafi 8, Bordi e ka për detyrë të sigurojë jo vetëm miratimin e buxhetit dhe përcaktimin e politikës së kompenzimit, por edhe të sigurojë që shpenzimet e televizionit publik nuk tejkalojnë të hyrat.

### 2.3. Shkelje e Nenit 12 të RTK-së mbi Produksionet e Pavarura dhe Ligjin e Prokurimit Publik

Bordi ka dështuar të sigurojë zbatimin e provizioneve të nenit 12.2 të Ligjit të RTK-së, i cili parasheh që televizioni publik për çdo vit do të shpallë konkurs publik për blerjen e veprave audiovizuele të produksioneve të pavarura, dhe t'i transmetojë në programin e vet, në pajtim me Ligjin dhe Statutin e RTK-së. Nuk është evidente zbatimi i tenderimit të hapur me qëllim të realizimit të misionit dhe përmbushjes së shijeve, kërkesave dhe interesave diverse të shikuesve dhe dëgjuesve të Kosovës. Nga mostrat e vështruara në platformën e prokurimit të hapur rezulton që ato janë bërë kryesisht përmes negocimit direkt.

Si rekomandim shtesë, Komisioni ka propozuar që:

- Anëtarët e ri të Bordit duhet të jenë personalitete me integritet të lartë profesional dhe etik. Ata duhet të mandatohen për të propozuar një strategji për RTK-në, për të siguruar pavarësi dhe financim adekuat, të qëndrueshëm, të justifikueshëm dhe llogaridhënie ndaj publikut.
- Të inicohet plotësim ndryshimi i Ligjit për RTK-në për të inkorporuar praktikat më të mira të operimit dhe financimit të televizioneve publike, përfshirë Parimet e Financimit të Televizioneve Publike në Ballkanin Perëndimor, të propozuara nga EBU në kuadër të projektit të mbështetur nga BE dhe Standardet e Financimit të Televizioneve Publike, të propozuara nga Këshilli i Evropës.

## 3. Arsyetimi i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Performanca e Bordit të RTK, reflektohet në Raportin vjetor të performancës së RTK, e cila nuk u miratua në Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal. Në këtë raport, nuk u gjet asnjë strategji apo vizion afatshkurtë apo afatgjatë lidhur me shfrytëzimin optimal të kapaciteteve të RTK, apo përgjithësisht iniciativa për reformim të RTK që të rrisë zbatueshmërinë e dispozitave ligjore. Njëkohësisht, raporti ishte vetëm një reflektim programor pa asnjë referim në problematikat dhe lëshimet me të cilat ky institucion ballafaqohen në vazhdimësi.

Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2020, kur flet për transmetuesit publik, në pjesë të ndara, thotë:

"*Mangësitë e RTK-së duhet të adresohen duke përfshirë rekrutimin jo të bazuar në merita, shpërblimet jotransparente, qëndrueshmërinë e pamjaftueshme të programeve në gjuhët joshumicë dhe praninë e dobët në internet.*"

Një qëndrim i tillë i Komisionit Evropian, konfirmon edhe një herë se RTK ka nevojë për një reformë të thellë, e cila nuk është e arritshme nga një Bord jokompetent. Ndërsa, evitimi i çfarëdo emërimi politik, mungese të meritokracisë në procese të brendshme apo shpërbime jo transparente, është pikërisht nën kompetencën e Bordit të RTK në përputhje me Nenin 29, Paragrafi 6, 7, 12, 14, 15 dhe 16, dhe dështimi i zbatimit të këtyre dispozitave, flet ndër të tjera edhe për jokompetenën e Bordit aktual.

Gjatë raportimit pranë këtij Komisioni, janë ngritur shumë shqetësime lidhur me performancën e Bordit. Madje, në raste kur për çështje që bien në mënyrë ekskluzive nën sferën e Nenit 29 të Ligjit për RTK që flet për kompetencat e këtij Bordi, u tha nga anëtarë të Bordit që nuk konsideruan që aspekte specifike vendimmarrëse bien nën kompetencë të Bordit, pavarësisht qartësisë ligjore të këtyre kompetencave. Më poshtë, adresohen disa nga shkeljet shtesë të evidentuara të këtij Bordi nga ky Komision.

Më 26.05.2021, Inspektorati i Punës ka marrë Vendim Nr. 01/06-03-1/21, me ç'rast ka konstatuar se në rastin e përzgjedhjes së Drejtorit për Shërbime të Përbashkëta, ka pasur mos-respektim të kritereve të konkursit. E megjithatë, ky Drejtor ka marrë përkrahjen e Bordit.

Gjatë raportimit në Komision, Bordi u pyet lidhur me qëndrimet që kishin karshi një emërimi të tillë, marrë për bazë vlerësimin e kundërligjshmërisë nga Inspektorati i Punës. Përveç mos ofrimit të sqarimeve shtesë për këtë shpërfillje të procedurave, në mbledhje u aludua në një votim konfidencial, i cili megjithatë pas pranimit të procesverbalit të mbledhjes ku Bordi votoi pro kandidatit të përzgjedhur nga komisioni, u pa që nuk kishte marrë vendim për votim të tillë të fshehtë. Asnjë nga anëtarët prezent në raportim nuk kontestuan thëniet se votimi ishte i fshehtë, duke lejuar kështu një mungesë të plotë të transparencës dhe thënieve të pasakta nga Bordi gjatë raportimit që drejtpërdrejtë cënon rolin fiduciar të Bordit ndaj Komisionit funksional.

Neni 29, Paragrafi 2.7., përcakton se Bordi, ndër të tjera:

> (...)
> *2.7.emëron dhe shkarkon zëvendësdrejtorët e përgjithshëm, drejtorët e Radiove dhe Televizioneve dhe udhëheqësin e shërbimeve të përbashkëta me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;*

(...)

*2.14. miraton kriteret kryesore profesionale për punësimin e personelit, politikave dhe procedurave të vlerësimit të përmbushjes së detyrave;*

Pra, në shpërputhje të kritereve që përcaktohen vet nga Bordi, ky i fundit miratoi propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, pa u lëshuar në konfirmimin e përmbushjes së kritereve përkatëse. Tutje, nuk ka asnjë indikacion që është kërkuar përgjegjësi nga menaxhmenti lidhur me dështimin e zbatimit të kritereve në fjalë.

Në rast tjetër, Neni 29, Paragrafi 2.15. përcakton se Bordi "*siguron që janë ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij ose KPM-së se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme;*"
Neni 29, Paragrafi 2.12. përcakton se Bordi i RTK "*miraton kodin e mirësjelljes për RTK-në dhe siguron **zbatimin efektiv të saj**;*"

Tre nga anëtarët e Bordit të tanishëm, kanë qenë anëtarë të Bordit edhe në vitin 2019 kur punëmarrës të RTK kanë bërë deklarime politike, dhe ndaj të cilëve asnjëherë nuk është ngritur procedurë disiplinore. Në fakt, anëtarët e tanishëm të Bordit, janë të gjithë të obliguar në përputhje me paragrafin 2.14. që të bëjnë vlerësimin e përmbushjes së detyrave të personelit, përfshirë atë të integrtetit, dhe të miratojnë e sigurojnë përmbushjen e kritereve profesionale.

Pavarësisht kësaj, në vitin 2020 ky Bord ka emëruar në personelin e tij, si zv. Drejtor, pikërisht persona që kanë shkelur Kodin e Mirësjelljes së RTK më parë.

Gjithashtu, me rastin e përzjedhjes së Drejtorit për Shërbime të Përbashkëta, dhe Drejtorit të Përgjithshëm, menaxhmenti i RTK ka shkelur Marrëveshjen Kolektive të RTK-së, ku kërkohet që përfaqësuesit sindikal të ftohen me rastin e intervistimit me gojë të kandidatëve. Kjo shkelje është konfirmuar nga Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr. 01/06-197-1/20. Sërish, nuk ka indikacione se Bordi ka ndërmarrë çfarëdo veprimi karshi menaxhmentit për mos-zbatimin e rregulloreve të brendshme gjatë intervistimit.

Rikujtojmë se përveç miratimit të kritereve kryesore profesionale, Bordi është i obliguar që të ndërmarre veprime që të sigurojë se janë ndërmarrë masa korrigjuese kur konstaton shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshe.

Njëkohësisht, në përputhje me Nenin 11 të Ligjit për RTK, ky medium obligohet ta sigurojë rrjetin e mbulueshmërisë, dëgjueshmërisë dhe shikueshmërisë në tërë territorin e Kosovës. Sidoqoftë, nga ky Bord nuk është parë asnjë veprim konkret në drejtim të një zgjidhjeje të qëndrueshme për të përmbushur këtë obligim, sidomos gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 ku sigurimi i një mbulueshmërie të tillë ka qenë esencial për të siguruar të drejtën kushtetuese të shkollimit të detyrueshëm, në rastet kur mundësitë lejonin vetëm mësimin virtual.

Në linjë të të gjithave që u thanë më sipër, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2021, me 6 vota "Për", vendosi t'i rekomandoj Kuvendit shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK. Në bazë të nenit 28, paragrafi 2, pika 2.2 të Ligjit për RTK: "*Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të RTK-së.*"

**Kryetarja e Komisionit,**

**Doarsa Kica-Xhelili**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
*Kuvendi – Skupština - Assembly*

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 08/358/Ko-238
Nr. i faqeve / No. pages:
Data / Datum / Date: 25.06.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**<u>VIII Saziv</u>**
**Prolećna sesija**

**ZA:** **Poslanike skupštine**
**CC:** **Predsedništvo skupštine**

**OD:** **Komisije za javnu upravu, lokalnu samoupravu, medije i regionalni razvoj**

**PREDMET: Preporuka o razrešenju članova borda RTK-a**

**Datum:** **25. jun 2021. god.**

Komisija za javnu upravu, lokalnu samoupravu, medije i regionalni razvoj, shodno članu 62. Poslovnika skupštine, člana 15. stav 2, podstav 2.2 Zakona br. 06/L-048 o RTK-u, na sednici održanoj 22. 6.2021. godine, raspravljala je o razrešenju članova borda RTK-a i odlučila da Skupštini podnese sledeću,

## P r e p o r u k u

**I. Preporučuje se Skupštini Republike Kosovo da razreši sledeće članove borda RTK-a ,**

1. Sali Bashota,
2. Agron Gashi,
3. Lirim Geci,
4. Ilir Bytyqi,
5. Albinot Maloku,
6. Bajram Mjeku,
7. Petrit Musolli, i
8. Fadil Miftari.

**II. Obrazloženje preporuke podneće predsednica komisije Doarsa Kica-Xhelili.**

## Obrazloženje

Komisija, u skladu sa članom 28. stav 2. Zakona br. 04 / L-046 o Radio-televiziji Kosova (u daljem tekstu: Zakon o RTK), pokrenula je postupak za razrešenje članova borda a Radio-televizije Kosova (u daljem tekstu: RTK).

U nastavku obrazloženja obrazložene su nadležnosti odgovarajućih komisija za predlaganje razrešenja članova borda RTK-a , imajući u obzir obrazloženje koje adresira kršenja ovog borda u odnosu na nadležnosti koje definiše član 29. Zakona o RTK-u .

### 1. Nadležnosti za razrešenje borda RTK-a

U skladu sa članom 28. stav 2. Zakona o RTK, razrešenje člana odbora može izvršiti:

*2.Razrešenje člana iz borda obaviće se prema sledećem postupku: 2.1. predlog za razrešenje dolazi od borda RTK-a na zahtev prostom većinom broja članova borda ili bilo koje druge spoljašnje inicijative pod uslovima navedenim u paragrafu 3. ovog člana.*
*2.2. Skupština Kosova prostom većinom odlučuje da li će razrešiti člana borda ili ne.*

Prema tome, u skladu sa gornjim paragrafom, član borda može biti razrešen, između ostalog, drugom inicijativom spolja, što znači izvan formata borda RTK, gde je zatim legitimisan glasanjem proste većine Skupštine Republike Kosovo.

U ovom slučaju, inicijativu su preduzela dve parlamentarne komisije Skupštine Republike Kosovo, odnosno Komisiaj za budžet, rad i transfere, koji su preporučili Komisiji za javnu upravu, lokalnu samoupravu, medije i regionalni razvoj da preispita preporuka za razrešenje borda RTK-a, zbog nalaza koji su obrazloženi u ovoj preporuci, prikazanih u tački 2. dole.

Komisija za javnu upravu, lokalnu samoupravu, medije i regionalni razvoj, kao funkcionalna komisija kojem RTK izveštava, podržala je preporuku Komsije za budžet, rad i transfere, sa 6 glasova za, nijedan protiv i nijedan uzdržan ., ali takođe dodajući sopstvene nalaze o propustima relevantnih odredbi Zakona o RTK, koji se prikazuju u tačci 3. dole.

U pogledu mogućnosti razrešenja članova jednog po jednog ili više članova borda, Zakon o RTK ne navodi jedinstvenu oznaku kao ograničenje mogućnosti otpuštanja više članova istovremeno. Kao referenca, postoje i drugi članovi u Zakonu o RTK koji se odnose na jedninu, ali se primenjuju u većini (vidi član 27).

Kao analogiju možemo uzeti praksu Skupštine Republike Kosovo u slučaju razrešenja dva člana Nezavisne komisije za medije 2013. godine. Zakon br. 04 / L-44 o Nezavisnoj komisiji za medije, kada govori o razrešenju svog člana, govori u jednini (tj. Odnosi se na člana), ali ipak na sednici od 19., 20. i 26. decembra 2013. god. istovremeno su razrešena dva člana Nezavisne komisije za medije.

Preporuka za razrešenje daje se u skladu sa članom 28. stav 3. Zakona o RTK koji govori o kriterijumima za razrešenje članova odbora, gde se između ostalog navodi trenutna osnova preporuke, i to:

3.1. profesionalna nesposobnost - ako dokaže i kontinuirano ne ispunjava dužnosti člana borda;

Kada govorimo o dužnostima člana borda, one su generalno uključene u sprovođenje Zakona o RTK, a posebno člana 29. Zakona o RTK.

## 2. Obrazloženje Komisije za budžet , rad i transfere

### 1. Neuspeh da se obezbedi transparentnost i odgovornost u vezi sa radom RTK-a

Članovi Upravnog odbora dosledno nisu uspeli da obezbede nesmetan i nesporan pristup Kancelariji generalnog revizora u pokretanju i dovršavanju revizija regularnosti i učinka. U skladu sa članom 136. stav 1. Ustava Republike Kosovo, Generalni revizor Republike Kosovo je najviša institucija ekonomske i finansijske kontrole, uključujući ekonomsku aktivnost javnih institucija. Zakon br. 04/L-046 definiše RTK kao javnu instituciju.

Zakon br. 03/L-221 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-048 o upravljanju javnim finansijama, član 19. stav 1. definiše da Generalni revizor za svaku fiskalnu godinu vrši reviziju izvršenja budžeta u svim budžetskim organizacijama, javnim autoritetima, javnim preduzećima i svim fondovima i javnim programima, bez obzira na način upravljanja ili finansiranja. Prema Zakonu o budžetskim izdvajanjima, član 3. stav 1.25. za 2021. godinu, RTK je budžetska organizacija sa organizacionim kodom 248 i koja je dobila godišnje finansiranje u iznosu od jedanaest miliona i dvesta hiljada evra (11.200.000 evra) u kategoriji subvencije i transferi. Sredstva prema Zakonu br. 07/L-041 dodeljuju se prema odluci Komisije za budžet i finansije.

Pravno mišljenje Opšte direkcije za pravna i proceduralna pitanja Skupštine Republike Kosovo, od 04.06.2021. godine, precizira da u okviru Zakona o RTK nikada nije postojala nijedna odredba koja osporava autoritet Nacionalne kancelarije za reviziju. Na osnovu dopisa primljenih od Nacionalne kancelarije za reviziju i izveštavanje Generalnog revizora u Komisiji za budžet, rad i transfere iz 2021. godine, postojale su stalne prepreke i osporavanje procesa revizije od strane Menadžmenta RTK-a. Amnestirajući ovu situaciju ometanja službenog lica, Odbor RTK nije uspeo da ima ulogu odlučivanja i nadzora kao što je definisano u članu 37. Zakona o RTK. Treba napomenuti da se u ovoj situaciji Odbor RTK podvrgao uputstvima generalnog direktora i to je u suprotnosti sa tačkom 25.7. Zakona o RTK. Ovim postupkom članovi Odbora RTK postupili su u suprotnosti sa stavom 2.10. člana 29. Zakona o javnom prenosniku i članom 136. Ustava Republike Kosovo.

## 2.2 Neuspešna izrada dugoročne strategije za razvoj i finansiranje RTK-a

2.1 Prema Zakonu o RTK-u, član 21. o izvorima finansiranja, javnoj televiziji je bilo predviđeno da prima sredstva iz državnog budžeta za trogodišnji prelazni period, sve dok se ne obezbedi finansiranje od pretplate. Osnivač je na predlog odbora RTK trebao da odluči o visini takse za javnog prenosnika, ali to se nije dogodilo. Trenutni odbor nije predložio nijednu strategiju koja bi javnosti obezbedila adekvatno, održivo i transparentno finansiranje. Iz zapisnika i diskusija sa sednica održanih tokom 2020. godine nije evidentirano da se o ovom pitanju diskutovalo ili tretiralo.

Tokom svog izveštavanja Komisiji za budžet, rad i transfere, Odbor nije uspeo da izvrši svoju fiducijarnu ulogu i da pošteno obavesti javnost o odredbama člana 23. o finansiranju od strane osnivača, prema kojem Skupština, u zavisnosti od budžetskih mogućnosti, predviđa finansijska sredstva. Komisija je bila pod stalnim pritiskom da vrši svoju nadzornu funkciju kako je predviđeno Zakonom o budžetskim izdvajanjima, Zakonom o RTK-u i Statutom RTK-a, koji je usvojio Odbor. Tromesečno i periodično izveštavanje Odbora definisano je u Zakonu o RTK-u, u tački 8. i 9. člana 30. o odgovornostima Odbora da obezbedi finansijsko izveštavanje na osnovu Zakona o upravljanju javnim finansijama. Tromesečni i godišnji finansijski izveštaji nemaju korelacije između aktivnosti i rashoda i nisu zasnovani na načelu nastanka prirasta. Oni nisu kategorizirani i u nekim slučajevima uključuju neplanirane i ponovljene troškove.

Na osnovu izvršenih finansijskih izveštaja, rashodi za plate RTK-a za 2008. godinu iznosili su 3.698.982 € od ukupnih troškova. Broj zaposlenih u 2008. godini bio je 424 plus 99 nezavisnih saradnika. U 2020. godini troškovi za plate i dnevnice, porasli su na 8.625.000 € od ukupnih troškova od 12.591.000 € ili 68,5%. U 2020. godini izvešteno je o 1.024 zaposlenih, od toga

806 sa redovnim ugovorima i još 218 sa honorarnim radom kao novinari, glumci ili dopisnici u inostranstvu. Ova tendencija trošenja i nekontrolisani porast broja zaposlenih prouzrokovao je ozbiljnu finansijsku situaciju u javnoj televiziji, izražena kroz dug u rasponu od 2,6 do 5,2 miliona evra, između 2018-2020. godine. Odbor bi trebalo da obezbedi da javna televizija ne bude samo na usluzi sebi, već i javnosti i ne samo da operiše, već i da ostane u konkurenciji sa ostalim komercijalnim kanalima, kako u pogledu tehnologije, tako i kvaliteta programa. Tolerišući takav razvoj događaja, Odbor nije ispunio svoju dužnost da kontroliše troškove javne televizije, kako je predviđeno u njihovoj nadležnosti. U skladu sa članom 26, stav 8, Odbor je dužan da obezbedi ne samo odobravanje budžeta i određivanje politike nadoknade, već i da osigura da rashodi javne televizije ne prelaze prihode.

### 2.1. Povreda člana 12. RTK-a o nezavisnim produkcijama i Zakona o javnim nabavkama

Odbor nije uspeo da obezbedi sprovođenje odredbi člana 12.2 Zakona o RTK-u, koji predviđa da javna televizija godišnje treba da objavi javni konkurs za kupovinu audiovizuelnih dela nezavisnih produkcija i za emitovanje u svom programu, u skladu sa Zakonom i Statutom RTK-a. Nije evidentno sprovođenje otvorenog tendera kako bi se ispunila misija i ispunili različiti ukusi, zahtevi i interesi kosovskih gledalaca i slušalaca. Iz uzoraka uočenih na platformi otvorene nabavke proizilazi da su oni realizovani uglavnom direktnim pregovaranjem.

Kao dodatnu preporuku, Komisija je predložila sledeće:

- Novi članovi odbora moraju biti ličnosti visokog profesionalnog i etičkog integriteta. Oni trebaju da imaju mandat da predlažu strategiju za RTK, kako bi se osigurala nezavisnost i adekvatno, održivo, opravdano i odgovorno javno finansiranje.

- Inicirati izmene i dopune Zakona o RTK/u radi inkorporisanja najboljih praksi u operisanju i finansiranju javnih televizija, uključujući Načela finansiranja javnih televizija na zapadnom Balkanu, koje je predložila EBU u okviru projekta koji podržavaju EU i u skladu sa Standardima finansiranja javnih televizija, predloženih od Saveta Evrope.

## 3. Obrazloženje Komisije za javnu upravu, lokalnu samoupravu, medije i regionalni razvoj

Učinak odbora RTK-a ogleda se u godišnjem izveštaju o učinku RTK-a, koji nije odobrila Komisija za javnu upravu, lokalnu samoupravu, medije i regionalni razvoj. U ovom izveštaju nije pronađena nikakva kratkoročna ili dugoročna strategija ili vizija u pogledu optimalnog korišćenja kapaciteta RTK-a, niti generalno inicijative za reformu RTK-a za povećanje sprovođenja zakonskih odredbi. U isto vreme, izveštaj je bio samo programski odraz bez ikakvog pozivanja na probleme i propuste sa kojima se ova institucija stalno suočava.

Izveštaj Evropske komisije o napretku za Kosovo za 2020. godinu, kada govori o javnim emiterima, u odvojenim delovima, kaže:

*„Treba rešiti nedostatke RTK-a, uključujući nezasnovano zapošljavanje na zaslugama, netransparentne nagrade, nedovoljnu održivost programa na nevećinskim jezicima i slabo prisustvo na Internetu."*

Takav stav Evropske komisije još jednom potvrđuje da je u RTK-u potrebna duboka reforma, koju nekompetentni odbor ne može postići. Dok izbegavanje bilo kakvog političkog imenovanja, nedostatak meritokratije u unutrašnjim procesima ili netransparentne usluge, je u nadležnosti odbora RTK-a, u skladu sa članom 29, stavovi 6, 7, 12, 14, 15 i 16, a neuspeh u primeni ovih odredbi, između ostalog govori o nesposobnosti sadašnjeg odbora.

Tokom izveštavanja ovoj Komisiji, izražena je mnoga zabrinutost u vezi sa učinkom Odbora. Štaviše, u slučajevima kada za pitanja koja potpadaju isključivo pod delokrug člana 29. Zakona o RTK-u, koji govori o nadležnostima ovog odbora, članovi odbora su rekli da nisu smatrali da određeni aspekti odlučivanja spadaju u nadležnost Odbora, uprkos zakonske jasnoće ovih ovlašćenja. Ispod su navedena dodatne povrede koja je ova Komisija utvrdila za ovaj odbor.

Dana 26.05.2021. godine, Inspektorat rada je doneo Rešenje br. 01/06-03-1/21, u kom slučaju je utvrđeno da je u povodom izbora direktora za zajedničke usluge došlo do nepoštovanja kriterijuma konkursa. Ipak, ovaj direktor je dobio podršku odbora.

Tokom izveštavanja u Komisiji, Odbor je upitan o stavovima koje su imali prema takvom imenovanju, uzimajući u obzir procenjenu nezakonitost od strane Inspektorata rada. Sem ne pružanja dodatnih pojašnjenja za ovo nepoštovanje procedura, na sastanku je aludirano i na poverljivo glasanje, za koje je, međutim, nakon prijema zapisnika sa sastanka na kojem je Odbor glasao u korist kandidata kojeg je komisija odabrala, zaključeno da nije doneta odluka za tajno glasanje. Nijedan od prisutnih članova na izveštavanje nije osporio navode da je glasanje bilo tajno, dozvoljavajući na taj način potpuni nedostatak transparentnosti i netačne izjave Odbora tokom izveštavanja, koji direktno ugrožava fiducijarnu ulogu Odbora nad Funkcionalnom komisijom.

Član 29, stav 2.7., utvrđuje da Odbor, između ostalog:

> (...)
> *2.7. Imenuje i razrešava zamenike generalnog direktora, direktore radio i televizije i rukovodioca zajedničkih usluga prostom većinom glasova, na predlog generalnog direktora;*
> (...)
> *2.14. odobrava glavne profesionalne kriterijume za zapošljavanje osoblja, politika i postupaka za ocenjivanje ispunjavanja dužnosti;*

Dakle, suprotno kriterijumima koje je odredio sam Odbor, odobrio je predlog Generalnog direktora, bez izdavanja potvrde o ispunjavanju relevantnih kriterijuma. Dalje, nema naznaka da je tražena odgovornost od rukovodstva zbog toga što nije primenilo dotične kriterijume.

U drugom slučaju, član 29. stav 2.15. utvrđuje da će Odbor *„obezbediti preduzimanje korektivnih mera nakon što on sam ili NKM utvrdi da je došlo do kršenja važećih standarda, propisa i zakona;“*
Član 29. stav 2.12. utvrđuje da odbor RTK-a *„usvaja Kodeks ponašanja za RTK i obezbeđuje* ***njegovu efikasnu primenu;“***

Tri člana trenutnog Odbora bili su članovi Odbora i 2019. godine kada su zaposleni u RTK-u davali političke izjave i protiv kojih nikada nije pokrenut disciplinski postupak. U stvari, svi trenutni članovi Odbora su obavezni u skladu sa stavom 2.14. da procene ispunjavanje zadataka osoblja, uključujući i integritet, i da usvoje i osiguraju ispunjenje profesionalnih kriterijuma.

Uprkos tome, ovaj Odbor je 2020. godine imenovao u svom osoblju za zamenike direktora, tačno osobe koje su ranije kršile Kodeks ponašanja RTK-a.

Takođe, prilikom izbora direktora za zajedničke usluge i generalnog direktora, rukovodstvo RTK-a prekršilo je Kolektivni sporazum RTK-a, koji zahteva da predstavnici sindikata budu pozvani tokom usmenog intervjua sa kandidatima. Ta povreda potvrđena je Rešenjem Inspektorata rada br. 01/06-197-1/20. Ponovo, nema naznaka da je Odbor preduzeo bilo kakve mere protiv rukovodstva zbog nepoštovanja internih propisa tokom intervjua.

Podsećamo vas da je pored usvajanja glavnih profesionalnih kriterijuma, Odbor dužan da preduzme mere kako bi se obezbedilo da su preduzete korektivne mere kada utvrdi kršenje važećih standarda, propisa i zakona.

Istovremeno, u skladu sa članom 11. Zakona o RTK, ovaj medij je dužan da obezbedi mrežu pokrivenosti, slušanosti i vidljivosti na celoj teritoriji Kosova. Međutim, ovaj odbor nije preduzeo konkretne mere u pravcu trajnog rešenja za ispunjavanje ove obaveze, posebno tokom perioda pandemije Covid-19, gde je obezbeđivanje takvog pokrivanja bilo neophodno za osiguranje ustavnog prava na obavezno obrazovanje, u slučajevima kada su mogućnosti dozvoljavale samo virtuelno učenje.

U skladu sa svim navedenim, Komisija je na sastanku održanom 22. juna 2021. godine, sa 6 glasova „za“, odlučila da preporuči Skupštini razrešenje članova odbora RTK-a. U skladu sa članom 28. stav 2. tačka 2.2 Zakona o RTK-u: *„Skupština Kosova prostom većinom odlučuje za razrešenje člana RTK-a ili ne.*

**Predsednica komisije,**

**Doarsa Kica-Xhelili**